



1481/1 10/04/26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.330/1 prot.

Peshkopi, më 10.04.2026

Lënda: Për vendimin nr.13, datë 07.04.2026 të Këshillit Bashkiak Dibër.

BASHKISË DIBËR
KËSHILLIT BASHKIAK DIBËR

DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit Bashkiak Dibër nr.13, datë 07.04.2026 “**Për rishikimin dhe përditësimin e programit të transparencës së Bashkisë Dibër me disa ndryshime**”, vendosa:

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën përkatëse, nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër që paraqesin për miratim projekt akte të kësaj natyre.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU



PRESHKOPJA DIBËR

Nr. 330 dt 09.04.26



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

1481

Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 09.04.2026

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.13

Datë: 07.04.2026 si dhe projekt-vendimin nr.01 Datë 25.03.2026.

**“PËR RISHIKIMIN DHE PËRDITËSIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË
BASHKISË DIBËR ME DISA NDRYSHIME”.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ilir Elezi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 13 Datë 07/04/2026

**“PËR RISHIKIMIN DHE PËRDITËSIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË
BASHKISË DIBËR ME DISA NDRYSHIME”**

Mbështetur në nenet 15, 18 pika 3, 54 shkronja “k”, të ligjit nr 139/2015 datë 17.02.2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjin nr.119/2014” Për të drejtën e informimit, Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.143, datë 24.12.2018, “ Për miratimin e Programit të Transparencës së Bashkisë Dibër”, Kryetari i Bashkisë, paraqet projektin përkatës dhe Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **07.04.2026**, me 16 vota pro, 1 kundër dhe 0 abstenim:

VENDOSI:

1. Miratimin e Programit të Transparencës të rishikuar dhe të përditësuar të Bashkisë Dibër sipas lidhjes bashkëngjitur.
2. Kryetari i Bashkisë është përgjegjës për përditësimin dhe zbatimin e programit të transparencës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
5. Vendimi u shpall me datë **07.04.2026**.

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Sokol Sava



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR

KRYETARI

PROJEKT-VENDIM

Nr. 01 Date / / 2026

“PËR RISHIKIMIN DHE PËRDITËSIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË BASHKISË DIBËR ME DISA NDRYSHIME”

Mbështetur në nenet 15, 18 pika 3, 54 shkronja “k”, të ligjit nr 139/2015 datë 17.02.2015 ” Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjin nr.119/2014” Për të drejtën e informimit, Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.143, datë 24.12.2018, “ Për miratimin e Programit të Transparencës së Bashkisë Dibër”, Kryetari i Bashkisë, ju paraqet projektin përkatës:

Për të vendosur:

1. Miratimin e Programit të Transparencës të rishikuar dhe të përditësuar të Bashkisë Dibër sipas lidhjes bashkangjitur.
2. Kryetari i bashkisë është përgjegjës për përditësimin dhe zbatimin e programit të transparencës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga Prefekti i Qarkut Dibër.

Koordinatorë për të drejtën e informimit

Donjila Shehi

Drejtor i Drejtorisë Juridike,

Ismet Saraci

KRYETARI I BASHKISË

Rahim SPAHIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR
KRYETARI

Peshkopi, më ___ / ___ 2026

RELACION

Për rishikimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës me disa ndryshime.

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Dibër

Të nderuar këshilltarë!

Në zbatim të përgjegjësisë të Bashkisë Dibër në garantimin e transparencës së veprimtarisë së saj, parashikuar nga neni 15 I ligjit nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", mbështetur edhe në modelin e programit të transparencës miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me urdhër nr. 211, datë 10.09.2018, Këshilli i Bashkisë Dibër, me vendim nr.143, datë 24.12.2018, ka miratuar Programin e Transparencës të Bashkisë Dibër.

Për tu garantuar qytetarëve sa më shumë transparencë, llogaridhënie, akses në qeverisje dhe kushtet e duhura për të ushtruar të drejtat e tyre qytetare, për ta informuar mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë, menaxhimin financiar, trajtimin e kërkesave për informacion, shërbimet publike që ofrohen dhe pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje, është parë e nevojshme rishikimi dhe përditësimi i Programit të Transparencës siç edhe parashikohet në nenin 5 të ligjit nr 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar ku citohet: "Rishikimi i programit të transparencës, bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës bëhet miratimi. Afatet për rishikimin e programit të transparencës mund të ndryshojnë në varësi të natyrës së çdo autoriteti publik, por në asnjë rast nuk mund të jenë më të gjata se 5 vjet.

Rishikimi dhe përditësimi i Programit të Transparencës, do të bëjë që informacioni i publikuar të jetë i aksesueshëm dhe lehtësisht i kuptueshëm nga individët dhe grupe të ndryshme të shoqërisë, duke respektuar kufizimet e arsyeshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë.

Nëpërmjet rishikimit dhe përditësimit të Programit të Transparencës, Bashkia Dibër vendos në dispozicion të qytetarëve një kategori të gjerë informacionesh, mënyrat dhe afatet e publikimit të tyre si dhe procedurat për të aksesuar e përdorur ato.

Në rishikimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës, Bashkia Dibër është bazuar në parimin e :

- a) **Vendosjes në dispozicion të çdo qytetari**, të të gjithë informacionit të prodhuar nga veprimtaria e bashkisë.
- b) **Ligjshmërisë, transparencës dhe të mos diskriminimit.**
- c) **Ofrimit të informacionit pa pagesë.** Informacioni i kërkuar në rrugë elektronike i jepet çdo qytetari pa pagesë. Çdo qytetar përfiton informacion pa pagesë deri në ...faqe, mbi këtë numër faqesh qytetari paguan një tarifë shërbimi prej...lekësh.
- d) **Aksesit për këdo.** Aksesit për shtresat më të varfra të komunitetit, qytetarët me aftësi të kufizuar, gratë, të rinjtë, biznesin, fermerët, qytetarët e zonave të largëta etj.
- e) **Thjeshtëzimit të procedurave** administrative për aksesin në informacion.
- f) **Dhënies së informacionit sa më shpejtë që të jetë e mundur.**
- g) **Cilësisë së informacionit**, i cili duhet të jetë: i plotë, i saktë; i përditësuar; i thjeshtë; i kuptueshëm; lehtësisht i aksesueshëm; i pajtueshëm me dokumentet origjinale në administrim të bashkisë dhe lehtësisht i përdorshëm.

Për t'i bërë më të thjeshtë, të kuptueshëm, të aksesueshëm dhe të përdorshëm kategoritë e informacionit, të parashikuar shprehimisht në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" (në vijim ligji), Komisioneri për të drejtën e Informimit ka vlerësuar propozimet për disa shtesa dhe ndryshime në Programin model të Transparencës të Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore që nuk ndryshojnë thelbin e përmbajtjes ekzistuese, por synojnë të konsolidojnë përvojën e mirë në forcimin dhe përmirësimin e transparencës së tyre.

Ndryshimet konkretisht janë:

1. Në Programin e Transparencës shtohet një fushë e re, Fusha 8 " Këshilli Bashkiak", dedikuar veprimtarisë së këtij organi të rëndësishëm. Në këtë fushë kërkohet të hidhet informacion lidhur me 8 nënfusha:
 - Informacion rreth këshilltarëve;
 - Informacion rreth komisioneve;
 - Kuadri rregullator i Këshillit Bashkiak;
 - Mbledhjet e Këshillit;
 - Konsultimet publike;
 - Vendimet e Këshillit Bashkiak;
 - Kërkesat dhe përgjigjet drejtuar Këshillit Bashkiak;
 - Veprimtaria e Këshillit, komunikimi me publikun dhe aspekte të tjera.
2. Fusha 1 " Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë " riformatohet në 6 nënfusha, pasi nënfushat 2 dhe 3 tashmë përfshihen në fushën 8.
3. Fusha 3 "Për kërkesat për informim" riformatohet në 4 nënfusha :
 - Të dhënat e Koordinatorit për të drejtën e informimit;

- Standartet dhe procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim dhe ankesës;
- Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve;
- Tarifa për dhënien e informacionit (nëse ka);

Nga ndryshimet e sipërcituara, Programi Model i Transparencës për Bashkinë Dibër do të jetë si më poshtë:

Fusha e parë: *Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë*, përfshin kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë të përcaktuar nga neni 7 (pika: a; d; g; ç, dh) i ligjit. Kjo fushë iu ofron qytetarëve informacion për ndarjen administrativo-territoriale, njësitë administrative përkatëse dhe nën-ndarjet e tyre, për misionin dhe funksionet e bashkisë, për organet e zgjedhura, për administratën e bashkisë, për statistikën vendore, për mekanizmat monitorues dhe të kontrollit si dhe për të drejtën e kërkesës, ankesave dhe vërejtjeve të qytetarëve që lidhen me veprimet ose mosveprimet e organeve dhe administratës së bashkisë.

Fusha e dytë: *Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare*, përfshin kategoritë e informacionit të përcaktuar nga neni 7 (pika:dh;e;ë) i ligjit. Këto kategori informacioni janë përshtatur me kërkesat e ligjit Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”. Në këtë fushë përfshihen informacione që kanë të bëjnë me planin strategjik të zhvillimit të bashkisë, me programin buxhetor afatmesëm vendor, me paketën fiskale (taksa dhe tarifa), me buxhetin vjetor, me zbatimin, monitorimin, mbikëqyrjen dhe auditimin e buxhetit, me donacionet si dhe shitjen ose dhënien me qira të pronave dhe asetëve.

Fusha e tretë: *Për kërkesat për informim*, përfshin vendosjen në dispozicion të qytetarëve të informacionit që ka të bëjë me procesin, procedurat, format dhe afatet e kërkesës për informim. Përmbledhja e katër kategorive të informacionit të përcaktuar në nenin 7 (pika c; ç; i; dhe k) të ligjit, në një fushë të vetme, lehtëson aksesin e qytetarëve për këto kategori informacioni, i orienton dhe udhëzon ato se si mund të bëjnë një kërkesë për informim.

Fusha e katërt: *Mbi shërbimet që ofron bashkia*, përfshin informacion mbi shërbimet që ofron bashkia të përcaktuara në nenin 7 (pika: f; j, ë dhe pjesërisht pika a) të ligjit.

Nëpërmjet kësaj fushe vihet në dispozicion të qytetarëve informacioni mbi shërbimet publike që ofron bashkia, llojet e shërbimeve, instrumentet e administrimit, kontratat publike, strukturat përgjegjëse, procedurën e ankimit në lidhje me kontratat publike, standardet, treguesit, procedurat për të përfituar shërbime si dhe procedurat e ankesës dhe vërejtjes në lidhje me shërbimet.

Fusha e pestë: *Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore*, informacion i përcaktuar në nenin 7, pika btë ligjit. Kjo fushë u ofron qytetarëve informacion për legjislacionin, politikën, vendimet, urdhëresat dhe urdhrat karakter normativ të organeve të bashkisë. Për të lehtësuar qasjen në informacion, fusha e legjislacionit është ndarë sipas funksioneve.

Fusha e gjashtë: *Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje*, përfshin informacion në lidhje me procesin, procedurat, kuadrin rregullator vendor, listën e akteve vendore qëi nënshtrohen

konsultimit publik dhe nismat qytetare.

Fusha e shtatë: *Informacion tjetër*, bashkia vë në dispozicion të qytetarëve informacion të ndryshëm të tillë si proceset e integritimit evropian (programet dhe projektet); shoqëria civile; raporte, studime dhe vlerësime të ndryshme, veçanërisht ato në lidhje me vlerësimin e transparencës etj; vet-organizimi komunitar etj.

Fusha e tetë: *Këshilli Bashkiak* përfshin vendosjen në dispozicion të qytetarëve të informacionit që ka të bëjë me këshilltarët (lista dhe kontaktet e tyre), kuadrin rregullator, komisionet, mbledhjet e këshillit, konsultimet publike, vendimet e Keshillit Bashkiak, kërkesat dhe përgjigjet e drejtuara këshillit, veprimtarinë e këshillit, komunikimi me publikun dhe aspekte të tjera.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, ju ftoj në miratimin e projektaktit!

KRYETARI I BASHKISË

Rahim SPAHIU



Lidhja nr. 1

PROGRAMI I TRANSPARENÇËS PËR BASHKINË DIBËR

TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENÇËS

Fusha 1 - Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë

Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin
1	<p>Organizimi administrativo-territorial, misioni dhe funksionet. Bashkia bën publike:</p> <ol style="list-style-type: none"> Ndarjen administrativo-territoriale <ul style="list-style-type: none"> Njësitë administrative dhe nën-ndarjet e tyre Të drejtat, përgjegjësitë dhe misionin e Bashkisë. Funksionet: Përfshin bërjen publike të: <ul style="list-style-type: none"> Funksioneve në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike Funksioneve në fushën e shërbimeve sociale Funksioneve në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese Funksioneve në fushën e mbrojtjes së mjedisit Funksioneve në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit Funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik vendor Funksioneve në fushën e sigurisë publike Funksionet dhe kompetencat e deleguara 	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/organizimi-dhe-funksionimi-i-bashkise/organizimi-admin-territorial/misionifunksionet/ Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	Menjëherë	Sipas akteve ligjore dhe nëligjore në fuqi	Kryetari i Bashkisë
2	<p>Organi ekzekutiv(Kryetari i Bashkisë). Përfshin bërjen publike të:</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit,</p>		Kryetari i Bashkisë	Kryetari i Bashkisë

<ul style="list-style-type: none"> - Procedurave të zgjedhjes - Detyrat dhe kompetencat - Të dhënat për arsimin, kualifikimet , paga e Titullarit dhe deklarimi i pasurisë - Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat me karakter normativ - Orari i pritjes së qytetarëve - Adresa postare/ elektronike 	<p>http://dibra.gov.al/organizimi-dhe-funksionimi-i-bashkise/organet-e-bashkise/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/organizimi-dhe-funksionimi-i-bashkise/administrata-e-bashkise/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>Menjëherë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Sekretari i Përgjithshëm</p>
<p>3</p> <ul style="list-style-type: none"> - Administrata e Bashkisë. Përfshin bërjen publike të: <ul style="list-style-type: none"> - Strukturës organizative dhe numrin e punonjësve - Rregullores së organizimit dhe funksionimit të administratës - Strukturës së pagave - Orarit të punës së bashkisë, njësi administrative dhe njësi të varësisë - Detyrave të administratës së njësi administrative - Organizimit dhe funksionimit të njësi në varësi - Njoftimeve mbi vende të lira pune dhe procedurat e rekrutimit - Adresave postare dhe elektronike e zyrave të bashkisë/njësi administrative/ njësi në varësi të bashkisë - Drejtuesit e zyrave, njësi administrative dhe njësi të varësisë 	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/organizimi-dhe-funksionimi-i-bashkise/mat-monitorues-dhe-te-kontrollit/</p> <p>Në vendet e</p>	<p>Brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të raportit përfundimtar</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>
<p>4</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit. Përfshin bërjen publike të: <ul style="list-style-type: none"> - Kartës së Auditimit të Brendshëm - Kodit të Etikës për audituesit e brendshëm - Planit strategjik dhe vjetor të njësisë së auditimit të brendshëm - Çdo raporti të auditimit të brendshëm të ushtruar në bashki. - Çdo raporti përfundimtar të kontrollit të jashtëm (KLSH) të ushtruar në bashki. - Planit të veprimit për zbatimin e 	<p>Në vendet e</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/organizimi-dhe-funksionimi-i-bashkise/mat-monitorues-dhe-te-kontrollit/</p> <p>Në vendet e</p>	<p>Në vendet e</p>	<p>Në vendet e</p>	<p>Në vendet e</p>

	rekomandimeve të lëna në përfundim të procedurave të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm	caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë	Sekretari i Përgjithshëm
5	<p>Kërkesa, ankesa, sinjalizime dhe vërejtje që lidhen me veprimet ose mosveprimet e organeve dhe administratës. Përfshin bërijen publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Procedurave për të bërë kërkesë, ankesë, vërejtje dhe sinjalizime organeve të bashkisë. - Rregullores së brendshme për procedurën e shqyrtimit, të hetimit administrativ, të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit - Njësisë përgjegjëse që regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet - Adresave postale/ elektronike për depozitimin e kërkesave, ankesave, sinjalizimeve apo vërejtjeve - Afateve dhe mënyrave të kthimit të përgjigjeve në lidhje me kërkesat, ankesat apo vërejtjet 	Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/ <u>organizimi-dhe-funksionimi-i-bashkise/procedura-t-e-berjes-se-kerkesave-ankesave-dhe-verejtjeve/</u>			
6	<p>Statistikat vendore. Përfshin bërijen publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kalendarit të publikimit të statistikave vendore - Statistikave vendore me të dhënat kyçe të bashkisë sipas fushave kryesore dhe të ndara sipas gjinisë - Strukturës përgjegjëse në bashki për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave vendore 	Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/ <u>organizimi-dhe-funksionimi-i-bashkise/statistika-vendore/</u>	Menjëherë pas miratimit	Kryetari i Bashkisë	Kryetari i Bashkisë
Fusha 2 - Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare					
Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin
1	Kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor	Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/	Në 10 ditëshin e parë të janarit	Këshilli Bashkiak	Kryetari i Bashkisë

	<p><u>/transparencia-</u> <u>dhe-</u> <u>llogaridhenia-</u> <u>ekonomikofinanc</u> <u>iare/kalendari-i-</u> <u>prg-buxhetor-</u> <u>afatemesemvjetor/</u></p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>		
2	<p>Paketa fiskale (taksa dhe tarifa). Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Bazës së taksave dhe tarifave 2. Nivelit të taksave dhe tarifave 3. Përfshitimeve dhe lehtësimeve të subjekteve të caktuara 4. Afateve të pagesave 5. Gjjobave dhe kamatëvonesave të aplikueshme 	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al <u>/transparencia-</u> <u>dhe-</u> <u>llogaridhenia-</u> <u>ekonomikofinanc</u> <u>iare/paketa-</u> <u>fiskale/</u></p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>Brenda 15 ditëve nga miratimi</p> <p>Këshilli Bashkiak</p> <p>Kryetari i Bashkisë</p>
3	<p>Plani Strategjik i Zhvillimit të bashkisë. Përmban:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Politikat për zhvillimin e qëndrueshëm në një afat kohor jo më pak se 5 vite 2. Synimet kryesore për çdo fushë përgjegjësi 3. Veprimet që duhen ndërmarrë duke parashikuar edhe kostot përkatëse 4. Burimet e financimit 	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al <u>/transparencia-</u> <u>dhe-llogaridhenia-</u> <u>ekonomikofinanci</u> <u>are/plani-</u> <u>strategjik-i-</u> <u>zhvillimit-te-</u> <u>bashkise/</u></p>	<p>10 ditë nga data e miratimit</p> <p>Këshilli Bashkiak</p> <p>Kryetari i Bashkisë</p>

4	<p>Programi buxhetor afatmesëm vendor. Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dokumentit të parë të programit buxhetor 2. Dokumentit të rishikuar të programit buxhetor afatmesëm 3. Dokumentit të plotë të programit buxhetor afatmesëm (përfshirë dokumentacionin shoqëruar) dhe informacionit për dy vitet e fundit, vitin buxhetor dhe tre vitet vijuese për çdo program (5 dokumentat përkatës) 	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparencadhe-llogaridhenia-ekonomikofinanciare/programi-buxhetor-afatmesem-vendor/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>Dokumenti i parë brenda datës 5 korrik. Dokumenti i rishikuar. Dokumenti i plotë jo më vonë se data 31 dhjetor.</p>	Këshilli i Bashkiak	Kryetari i Bashkisë
5	<p>Buxheti. Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Buxhetit vjetor së bashku me dokumentacionin shoqëruar të tij (12 dokumentat përkatës) 2. Treguesve financiarë 3. Numrit të punonjësve buxhetorë, për çdo njësi shpenzuese 4. Regjistrin të parashikimeve të prokurimit publik 	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparencadhe-llogaridhenia-ekonomikofinanciare/buxheti-vjetor/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>15 ditë pas miratimit nga Këshilli i NJVV. Regjistrin e parashikimeve të prokurimit publik 10 (dhjetë) ditë pas miratimit të buxhetit.</p>	Këshilli i Bashkiak	Kryetari i Bashkisë
6	<p>Zbatimi i buxhetit. Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Raportit mujor (pas datës 30 prill të çdo viti buxhetor) të përmbledhur mbi ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve (8 raporte) 	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparencadhe-llogaridhenia-ekonomikofinanciare/zbatimi-j-</p>	<p>Jo më vonë se data 10 e muajit pasardhës</p>	Kryetari i Bashkisë Informohet Këshilli i Bashkisë	Kryetari i Bashkisë

	<p><u>buxhetit/</u></p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>		<p>Raportet e monitorimit të zbatimit.</p> <p>Kryetari i Bashkisë (Informohet Këshilli Bashkiak)</p> <p>Raporti vjetor i konsoliduar miratohet nga Këshilli Bashkiak .</p> <p>Regjistri i realizimeve të prokurimit Kryetari i Bashkisë (Informohet Këshilli Bashkiak)</p>	Kryetari i Bashkisë
7	<p>Monitorimi dhe mbikëqyrje e buxhetit:</p> <ol style="list-style-type: none"> Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit (jo më pak se tre raporte katër-mujore) Raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit <ol style="list-style-type: none"> Raportit të performancës vjetore Pasqyrave financiare vjetore (dokumentacionin bazë dhe shoqërues) Informacionit për zbatimin dhe monitorimin e kontratave (punëve publike, mallrave, shërbimeve) Regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit publik 	<p>Raportet e monitorimit brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit.</p> <p>Raporti vjetor i konsoliduar brenda muajit qershor të vitit buxhetor pasardhës.</p> <p>Regjistri i realizimeve të procedurave të prokurimit publik jo më vonë se datat 10 maj, 10 shtator dhe 10 janar të çdo viti.</p> <p>Brenda 10 ditëve nga shpallja.</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparencja-dhe-logaridhenia-ekonomikofinanciare/monitorimi-mbikëqyrja-dhe-auditimi-i-buxhetit/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	Kryetari i Bashkisë
8	<p>Vështirësitë financiare. Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> Planit për daljen nga situata e vështirë financiare 	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparencja-dhe-logaridhenia-ekonomikofinanciare/veshtiresite-financiare/</p>	<p>Këshilli Bashkiak</p>	Kryetari i Bashkisë

9	<p>Shitja ose dhënia me qira e pronave dhe asetëve Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Aseteve dhe pronave të ofruara për shitje ose dhënie me qira 2. Kriteve që duhet të plotësohen 	<p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p> <p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparenca-dhe-llogaridhenia-ekonomikofinanciare/shitja-ose-dhenia-me-qira-e-pronave-dhe-aseteve/</p>	Kryetari i Bashkisë	Kryetari i Bashkisë	
10	<p>Donacionet. Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Emrit të donatorit 2. Shumës së donacionit 3. Qëllimit e donacionit 	<p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p> <p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparenca-dhe-llogaridhenia-ekonomikofinanciare/donacionet/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë	
Fusha 3- Për kërkesat për informim					
Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin

1	<p>Të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit (Emri, kontaktet dhe kompetencat) Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Emrit mbiemrit të Koordinatorit 2. Adresës postare/elektronike të tij 3. Orarit të punës 4. Detyrave dhe kompetencave të Koordinatorit <p>Adresës postare/elektronike për depozitimin e kërkesave për informim</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparenca/koordinatori/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për të drejtën e informimit
2	<p>Standardet dhe procedurat që duhen ndjekur për të bërë kërkesë për informim dhe ankesës. Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Procedurës që duhet ndjekur për të bërë një kërkesë për informacion 2. Adresës postare/elektronike për dërgimin e kërkesës për informim 3. Modelit standard të një kërkesë për informim 4. Afateve të marrjes së përgjigjes 5. Procedurave që duhet ndjekur për të bërë një ankesë për mos dhënie informacioni <p>Adresës postare/elektronike për dërgimin e ankesës për mos dhënie informacioni</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/kerkesat-per-informim/standart-et-dhe-procedurat-e-kerkesave/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	Brenda 48 orëve prej miratimit të tyre	Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për të drejtën e informimit
3	<p>Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve. Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të gjitha kërkesave për informim 2. Informacionet e dhënë në përgjigje të kërkesave për informim <p>Përditësimi i regjistrit</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/kerkesat-per-informim/regjistri-i-kerkesave-dhe-pergjigjeve/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për të drejtën e informimit
4	<p>Tarifave për dhënie informacionin (nëse ka) Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Tarifave 2. Rregullave për mënyrën e kryerjes së pagesës <p>Subjekteve që përfitojnë informacionin falas</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/kerkesat-per-informim/tarifa-per-dhënie-e-</p>	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për të drejtën e informimit

	informacionit/	Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative		
Fusha 4 - Mbi shërbimet që ofron bashkia				
Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues
1	<p>Shërbimet Përfshin bërjen publike të shërbimeve publike që ofron bashkia sipas fushave të përcaktuara nga ligji 139/2015</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Shërbimet në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike 2) Shërbimet në fushën e shërbimeve sociale 3) Shërbimet në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese 4) Shërbimet në fushën e mbrojtjes së mjedisit 5) Shërbimet në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit 6) Shërbimet në fushën e zhvillimit ekonomik vendor 7) Shërbimet në fushën e sigurisë publike 8) Shërbimet në fushën e funksioneve dhe kompetencave të deleguara..... <p>Për çdo shërbim (por pa u kufizuar) informacion përshkruet mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Instrumentin për administrimin e shërbimit ✓ Sistemin e administrimit të performancës së shërbimit bazuar mbi standardet ✓ Sistemin e treguesve, përfshirë edhe aspektin gjinor për matjen e performancës ✓ Strukturën përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës së shërbimit, përfshirë edhe aspektin gjinor 	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparencave/ven-dime-te-keshillit-bashkiak-diber/sherbimet/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë

2	<p>Shërbimet administrative Përfshin bërjen publike të shërbimeve publike që ofron bashkia sipas fushave të përcaktuara nga ligji 139/2015</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Shërbimet administrative në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike 2) Shërbimet administrative në fushën e shërbimeve sociale 3) Shërbimet administrative në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese 4) Shërbimet administrative në fushën e mbrojtjes së mjedisit 5) Shërbimet administrative në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit 6) Shërbimet administrative t në fushën e zhvillimit ekonomik vendor 7) Shërbimet administrative në fushën e sigurisë publike <p>Shërbimet administrative në fushën e funksioneve dhe kompetencave të deleguara për çdo shërbim (por pa u kufizuar) informacion përshkruet mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Strukturat përgjegjëse për ofrimin e shërbimit - Adresën postare/elektronike të strukturave/njësive/sporteve që ofrojnë shërbime administrative - Procedurat që duhen ndjekur për të përfituar shërbime administrative - Oraret e punës së strukturave/njësive/sporteve që ofrojnë shërbime administrative - Tarifat për shërbimet administrative - Rregullat për mënyrën e kryerjes së pagesës - Subjektet që përjashtohen nga tarifat 	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparencave/ven-dime-te-keshillit-bashkiak-diber/sherbimet-administrative-sipas-7-funksioneve/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë
3	<p>Kontratat publike. Përfshin bërjen publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Objektivit të kontratës publike - Numrit të referencës së procedurës/ kontratës - Llojit të procedurës - Termave dhe kushteve të kontratës - Kohëzgjatjes së kontratës 	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparencave/ven-dime-te-keshillit-bashkiak-</p>	Publikimi brenda 5 (pesë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës	Kryetari i Bashkisë

<ul style="list-style-type: none"> - Vlerës së kontratës - Dhëname të autoritetit kontraktor - Dhëname të kontraktorit/ nënkontraktorit - Treguesve për matjen e përmbushjes së kontratës - Strukturave publike përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e kontratës - Procedurave që duhet ndjekur për të bërë një ankimim - Raporteve të kontrollit, monitorimit dhe auditimit mbi zbatimin e kontratës 	<p><u>diber/kontratat-publike/</u></p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>		
4	<p>E drejta e ankesës dhe vërejtjes në lidhje me shërbimet</p> <p>Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Procedurave për të bërë ankesa apo vërejtje në lidhje me shërbimet 2. Adresës postare/elektronike për depozitimin e ankesave apo vërejtjeve 	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparencia/ven-dime-te-keshillit-bashkiak-diber/e-drejta-e-ankeses-dhe-verejtjes-ne-lidhje-me-sherbimet/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>Brenda 10 ditëve nga shpallja e miratimit</p> <p>Kryetari i Bashkisë</p> <p>Kryetari i Bashkisë</p>
<p>Fusha 5 - Legjislativi dhe aktet e brendshme rregullatore</p>			
Nr.	<p>Informacioni që bëhet publik pa kërkesë</p>	<p>Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni</p>	<p>Afati kohor për publikim</p> <p>Organi miratues</p> <p>Organi përgjegjës për publikimin</p>

1	<p>Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) I organizuar (jo i detyrueshëm) sipas fushave: <ul style="list-style-type: none"> - Fusha e organizimit dhe funksionimit të bashkisë - Fusha e veprimit të ekonomiko-financiare - Fusha e qeverisjes së mirë vendore (integriteti, etika, anti-korrupsioni, transparencë, llogaridhënia etj) - Fusha e infrastrukturës dhe shërbimeve publike - Fusha e shërbimeve sociale - Fusha e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese - Fusha e mbrojtjes së mjedisit - Fusha e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullorave publike, natyrës dhe biodiversitetit - Fusha e zhvillimit ekonomik vendor - Fusha e sigurisë publike - Fusha e funksioneve dhe kompetencave të deleguara 2) Çdo fushë duhet të përmbajë: <ul style="list-style-type: none"> - Aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse - Dokumentet politike kombëtar përkatës - Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e këshillit të bashkisë me karakter normativ - Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e kryetarit të bashkisë me karakter normativ - Dokumentet politike vendor 	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparencallegjislacioni-dhe-aktet-e-brendshme-rregullatore/</p>	<p>Menjëherë pas botimit në fletore zyrtare.</p> <p>Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e këshillit dhe Kryetarit të Bashkisë brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre</p>	<p>Kuvendi i Shqipërisë</p> <p>Këshilli i Ministrave</p> <p>Ministri</p> <p>Këshilli Bashkiak</p> <p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>
<p>Fusha 6 - Pjesëmarrja qytetare në vendimarrje</p>					
Nr.	<p>Informacioni që bëhet publik pa kërkesë</p>	<p>Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni</p>	<p>Afati kohor për publikim</p>	<p>Organi miratues</p>	<p>Organi përgjegjës për publikimin</p>
1	<p>Të dhënat e koordinorit për njoftimin dhe konsultimin publik. Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Emër mbiemër të koordinatorit 2. Adresën postare/ elektronike të tij 3. Orarin e punës 	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparencallegjislacioni-dhe-aktet-e-brendshme-rregullatore/</p> <p>Në vendet e caktuara për</p>	<p>Menjëherë pas miratimit të urdhrat të caktimit të Koordinatorit</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik</p>

2	<p>Plani vjetor për procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrje. Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Akteve që do të konsultohen 2. Mënyrat e konsultimit 3. Afatet <p>Strukturat përgjegjëse</p>	<p>njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p> <p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparencapjesemarrja-qytetare-ne-vendimmarrje/plani-vjetor-per-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjesemarrje/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>Brenda 10 ditëve nga data e miratimit</p>	<p>Këshilli i NJVV Titullari i NJVV</p>	<p>Sekretari i Këshillit Bashkiak Kordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik</p>
3	<p>Dispozitat e brendshme rregullatorë për këshillimin me publikun. Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Procedurave, afateve dhe mënyrat e organizimit për çdo formë/lloj konsultimi <p>Strukturat përgjegjëse për aktet e detyrueshme për konsultim</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparencapjesemarrja-qytetare-ne-vendimmarrje/dispozitat-e-brendshme-rregullatore-per-keshillim/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>Brenda 10 ditëve nga data e miratimit</p>	<p>Këshilli i NJVV Titullari i NJVV</p>	<p>Sekretari i Këshillit Bashkiak Kordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik</p>

4	<p>Akte për të cilët është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit publik. Përshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> Listës së akteve për të cilët është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit publik 	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparencia/pjesemarrja-qytetare-ne-vendimmarrje/akt-et-per-te-cilet-eshte-e-detyrueshme-zhvillimi-i-konsultimit/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	Menjëherë	Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik	Sekretari i Këshillit Bashkiak Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik
5	<p>Njoftimi për nismën vendimmarrëse me pjesëmarrje Përshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> Projektaktit, relacionin shpjegues dhe dokumentave shoqërues të tij; Arsyeve të nevojshme për nxjerrjen e projektaktit, si dhe ndikimi që ai do të ketë Afatit, vendit dhe mënyrën me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre; Adresën e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik të bashkisë ose të strukturës përgjegjëse për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin; Vendin dhe datën e organizimit të takimit publik në rastet kur bashkia vendos për organizimin e tij 	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparencia/pjesemarrja-qytetare-ne-vendimmarrje/njoftimi-per-nismen-vendimmarrrese-me-pjesemarrje/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	Menjëherë	Këshilli Bashkiak Kryetari i Bashkisë	Sekretari i Këshillit Bashkiak Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik
6	<p>Procedura e marrjes dhe shqyrtimit të komenteve dhe rekomandimeve. Përshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> Adresën postare/ elektronike për dërgimin e 	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/t</p>	Menjëherë	Këshilli Bashkiak	Sekretari i Këshillit Bashkiak

	<p>komenteve dhe rekomandimeve</p> <p>2. Afatin për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve</p> <p>3. Mënyrën e mbajtjes së procesverbalit dhe regjistrimit të takimit publik për takimet publike</p> <p>4. Mënyrën e trajtimit të komenteve dhe rekomandimeve</p> <p>Mënyrën e dhënies së arsyeve për mospranimin komenteve dhe rekomandimeve</p>	<p><u>transparenca/pjesemarrja-qytetare-ne-vendimmarrje/procedurat-e-marrjes-dhe-shyrtimit-te-komenteve-dhe-rekomandimeve/</u></p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>		<p>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik</p>
7	<p>Procedurat që duhen ndjekur për të bërë një ankim në lidhje me konsultimin publik.</p> <p>Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Subjektet ku mund të bëhet ankesa (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale Këshilli Bashkiak, Kryetari i Bashkisë;) 2. Adresën postare/ elektronike për dërgimin e ankesës 3. Procedurat për të bërë një ankesë në lidhje me këshillimin me publikun 4. Struktura përgjegjëse në nivel bashkie që regjistron dhe shqyrton ankesën 	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al <u>/transparenca/pjesemarrja-qytetare-ne-vendimmarrje/procedurat-e-ankimimit-lidhur-me-procesin-e-keshillimit/</u></p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>Menjëherë</p> <p>Këshilli Bashkiak</p>	<p>Sekretari i Këshillit Bashkiak</p> <p>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik</p>
8	<p>Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes. Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Numrit të akteve të miratuara nga organet e bashkisë me konsultim publik gjatë një viti. 2. Numrin e përgjithshëm të komenteve dhe rekomandimeve të marra nga palët e interesuara; 3. Numrin e rekomandimeve dhe komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes. 	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al <u>/transparenca/pjesemarrja-qytetare-ne-vendimmarrje/raporti-vjetor-per-transparenca-ne-</u></p>	<p>Brenda 10 ditëve nga data e miratimit</p> <p>Këshilli Bashkiak Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Sekretari i Këshillit Bashkiak</p> <p>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik</p>

4.	Numrin e takimeve publike të organizuara	<p><u>procesin-e-vendimmarrjes/</u></p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p> <p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparenca/pjesemarrja-qytetare-ne-vendimmarrje/iniciativa-qytetare/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit	Këshilli Bashkiak	Sekretari i Këshillit Bashkiak Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik
----	--	--	--	---------------------------------------	-------------------	---

Fusha 7 - Informacion tjetër

Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin
1	<p>Bashkia në proceset e integritit evropian. Përfshin bërjen publike të:</p> <p>1. Të dhënave për projektet, nismat dhe veprimtarisë së bashkisë në kuadrin e integritit në BE.</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparenca/info-mmacion-tjeter/bashkia-ne-proceset-e-integritit-evropian/</p> <p>Në vendet e caktuara për</p>	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre	Kryetari i Bashkisë	Kryetari i Bashkisë

	njoftim publik dhe Njësitë Administrative			Kryetari i Bashkisë
2	<p>Bashkia dhe shoqëria civile. Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Në tërësi të dhëna për grupet e interesit 2. Të dhëna për OJF, përfaqësuesit e medias, biznesit 3. Shërbimet që ofrohen nga organizata të ndryshme 4. Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile 	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparencia/info/rmacion-tjeter/bashkia-dhe-shoqeria-civile/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre	Kryetari i Bashkisë
3	<p>Raporte, studime dhe vlerësime mbi zbatimin e Programit të transparencës. Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Raporte, studime dhe vlerësime mbi PT 2. Sisteme/metodologji matje të PT 	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparencia/info/rmacion-tjeter/raporte-studime-dhe-vleresime-mbi-zbatimin-e-transparences/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre	Kryetari i Bashkisë
4	<p>Strukturat komunitare Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dhënave për strukturat komunitare në fshat 2. Dhënave për strukturat komunitare në qytet 3. Detyrat, kompetencat dhe kompetencat e strukturave komunitare 	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparencia/info/rmacion-tjeter/raporte-studime-dhe-vleresime-mbi-zbatimin-e-transparences/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre	Kryetari i Bashkisë

	4. Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e këshillave komunitare	tjeter/strukturat-komunitare/ Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative			
Fusha 8 – Këshilli Bashkiak					
Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin
1	Informacion rreth këshilltarëve: Përfshin bërjen publike të: 1. Lista e këshilltarëve. 2. Biografi e shkurtër e këshilltarëve. 3. Kontakte të këshilltarëve nr. telefonit/ email-i zyrtar.	Në faqen zyrtare të internetit http://dibra.gov.al/kryetari-i-keshillit/ Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre	Këshilli Bashkiak	Këshilli Bashkiak
2	Informacion rreth komisioneve: Përfshin bërjen publike të: 1. Përshkrimi dhe përbërja e komisioneve. 2. Njoftim për takimet e komisioneve. 3. Agjenda dhe dokumentet për diskutim. 4. Raportet e mbledhjeve të komisioneve për projekt-aktet e diskutuara.	Në faqen zyrtare të internetit- http://dibra.gov.al/komisionet-e-keshillit/ Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre	Këshilli Bashkiak	Këshilli Bashkiak

3	<p>Kuadri rregullator i këshillit bashkiak :Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ligje dhe udhëzime për qeverisjen vendore me fokus këshillat. 2. Rregullore e funksionimit të këshillit të bashkisë. 3. Kodi i sjelljes dhe i parandalimit të konfliktit të interesave të këshilltarëve të bashkisë. 4. Rregullore për marrëdhënien e këshillit bashkiak me publikun dhe median. 5. Rregullore për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesave, vërejtjeve, kërkesave, peticioneve, dhe iniciativave qytetare. 	<p>Në faqen zyrtare të internetit http://dibra.gov.al/rregullore-e-keshillit/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre</p>	<p>Këshilli Bashkiak</p>	<p>Këshilli Bashkiak</p>
4	<p>Mbledhjet e këshillit: Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Njoftimi paraprak për mbledhjet (data, ora, vendi, agjenda). 2. Dokumente përgatitore për mbledhjet. 3. Procesverbalet dhe vendimet pas mbledhjeve. 4. Mbledhjet live të Këshillit . 	<p>Në faqen zyrtare të internetit- http://dibra.gov.al/procesverbal-mbledhesh/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre</p>	<p>Këshilli Bashkiak</p>	<p>Këshilli Bashkiak</p>
5	<p>Konsultimet publike:Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të dhënat e Sekretarit të Këshillit Bashkiak (Emër Mbiemër, telefon, adresë email). 2. Plani vjetor i konsultimeve të Këshillit. 3. Regjistri i projekt-akteve për konsultim. 4. Njoftimi i konsultimeve në faqen e internetit të Këshillit. 5. Përmbledhje e pas-konsultimit në raport zyrtar. 6. Raporti vjetor i transparencës së konsultime publike/dëgjesave publike. 	<p>Në faqen zyrtare të internetit http://dibra.gov.al/konsultime-publike/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre</p>	<p>Këshilli Bashkiak</p>	<p>Këshilli Bashkiak</p>
6	<p>Vendimet e Këshillit Bashkiak:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Projekt-Vendimet e Këshillit Bashkiak 2. Vendimet e Këshillit Bashkiak (relacionet dhe 	<p>Në faqen zyrtare të internetit</p>	<p>Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre</p>	<p>Këshilli Bashkiak</p>	<p>Këshilli Bashkiak</p>

	<p>çdo dokument tjetër bashkëlidhur vendimit).</p>	<p>http://dibra.gov.al/projektvendi/met/</p> <p>http://dibra.gov.al/vendimet-e-keshillit-bashkiak/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>		
7	<p>Kërkesat dhe përgjigjet drejtuar Këshillit Bashkiak:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe ankesës pranë Këshillit Bashkiak. 2. Formular për dorëzimin e kërkesave Këshillit Bashkiak. 3. Formular për dorëzimin e ankesave Këshillit Bashkiak. 4. Regjistër i kërkesave dhe përgjigjeve i Këshillit Bashkiak (përfshirë përgjigjen e dhënë, të anonimizuar) 	<p>Në faqen zyrtare të internetit</p> <p>http://dibra.gov.al/regjistri-i-aneksave-kerkesave-dhe-verejtjeve/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre	Këshilli Bashkiak
8	<p>Veprimtaria e Këshillit, Komunikimi me Publikun dhe aspekte të tjera:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Raporti vjetor i punës së këshillit. 2. Buxheti vjetor i këshillit. 3. Raporti vjetor i konsoliduar për zbatimin e buxhetit. 4. Kalendari vjetor për trajnimet. 5. Vlerësim i performancës së këshilltarëve nga aktorë të brendshëm. 6. Vlerësim i performancës së këshilltarëve nga 	<p>Në faqen zyrtare të internetit</p> <p>http://dibra.gov.al/regjistri-i-brendshem-i-peticioneve-dhe-iniciativave-</p>	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre	Këshilli Bashkiak

<p>OSHC-të.</p> <p>7. Regjistër i peticioneve dhe iniciativave qytetare.</p> <p>8. Deklaratë publike e Titullarit/es së Këshillit për përmirësimin e transparencës.</p> <p>9. Regjistër i OSHC-ve dhe ekspertëve lokalë.</p> <p>10. Statistika</p>	<p><u>qytetare/</u></p> <p><u>http://dibra.gov.al/programi-i-transparencese-keshillit/</u></p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>		
--	---	--	--